



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 513

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 435, NGA ZJ. ALBANA VOKSHI PËR HAPIJEN E ZYRËS ZGJEDHORE NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" AFËR QV-SË, BASHKIA DURRËS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 13 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

**KËRKUES:** Zj. Albana Vokshi

**OBJEKTI:** Kërkohe marrja e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për hapjen e zyrës zgjedhore nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", afër QV-së Shkolla "Demokracia", Bashkia Durrës.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Zj. Albana Vokshi ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve denoncimin regjistruar me nr. 435 ID, datë 13.5.2023.

Zj. Vokshi pretendon se subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka hapur zyrë zgjedhore në një distancë të afërt me vendndodhjen e QV-së, Shkolla "Demokracia", Durrës.

Data: 13.5.2023 Nr: 513  
Ora: 17:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr.435, nga zj. Albana Vokshi për hapjen e zyrës zgjedhore nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" afër QV-së, Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi vlerësojmë se, zyra zgjedhore është vendosur në kundërshtim të nenit 5, pika 1 të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n", e pika 2, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

#### **V E N D O S:**

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Durrës, për mbylljen e menjëhershme të zyrës afër QV-ve, Shkolla Demokracia, Durrës.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Durrës për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t'u njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Durrës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**